



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Deoničarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Në mbështetje të nenit 3 paragrafit 1, nën-paragrafit 1.4 dhe nenit 9 paragrafit 8, nën-paragrafit 8.1 të Ligjit Nr. 05/L-120 për Trepçën (GZ/ Nr. 36 / 31 tetor 2016), të nenit 6 paragrafi 2, nenit 19 paragrafit 2, nën-paragrafit 2.11, dhe nenit 22 të Statutit të Trepça Sh.A, të nenit 17 dhe 21 paragrafët 3 dhe 4 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, (G Z / Nr. 31/15 qershor), si dhe nenit 13 i Ligjit Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, G Z/Nr. 13/30 maj 2012, vendimit të marrë në mbledhjen e mbajtur me datën 08.12.2023, Bordi i Përkohshëm Mbikëqyrës i Trepça Sh.A. shpall:

KONKURS

Pozita: Kryeshef Ekzekutiv i Trepça Sh.A

Vendi i punës: *Mitrovicë-Parku Industrial;*

I përgjigjet: *Bordit Mbikëqyrës të Drejtorëve;*

Kohëzgjatja e kontratës: *Tri (3) vite, me mundësi vazhdimi; ndërsa performanca e Zyrtarit të Lartë do t'i nënshtrohet vlerësimit të vazhdueshëm nga Bordi i Drejtorëve*

Paga: *Në pajtim me deklaratën për politiken e kompensimit të aprovuar nga Bordi Mbikëqyrës i Drejtorëve;*

Orari i punës: *I plotë*

1. Të përgjithshme

Kandidatët për këtë vend pune duhet të jenë persona me integritet, të cilët plotësojnë kushtet e kualifikimit, kriteret e pavarësisë, duhet të kenë përvojë të nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar, dhe kushtet tjera të kërkuara me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligjit Nr. 05/L-120 për Trepçën, Statutin e Trepça Sh.A.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

- Përgjegjës për të gjitha punët dhe veprimtarinë e Ndërmarrjes konform Ligjit për Shoqëritë Tregtare, Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike, Ligjin mbi Trepçën, Statutit, Rregulloreve të Ndërmarrjes dhe akteve tjera normative;
- Përgjegjës për menaxhimin e përgjithshëm të ndërmarrjes duke siguruar qëndrueshmërinë afatgjate financiare të saj;
- Harton, udhëheq dhe mbikëqyr implementimin e planit të biznesit të ndërmarrjes, planeve afatshkurta dhe afatmesme të ndërmarrjes në dakordim me strategjinë e ndërmarrjes të aprovuar nga Bordi Mbikëqyrës;
- Përgatit dhe mbikëqyr zbatimin e planeve vjetore të biznesit të ndërmarrjes, përfshirë administrimin e buxhetit vjetor për operime, mirëmbajtje, shpenzime, paga dhe shpenzime kapitale;
- Në bashkëpunim të ngushtë me Bordin Mbikëqyrës, udhëheq zhvillimin strategjik të Ndërmarrjes;
- Raporton dhe zbaton vendimet e Bordit Mbikëqyrës të Trepça Sh.A;
- Monitoron likuiditetin e ndërmarrjes dhe planifikimin e rrjedhës së arkës në periudhë afatshkurtër dhe afatgjatë;
- Zhvillon dhe implementon në përpikëri programin për përmirësimin e performancës financiare;
- Ngrit kapacitetet prodhuese dhe operationale të Njësive Biznesore të Trepça Sh.A;
- Planifikon dhe mirëmban sistemin infrastrukturor fizik të ndërmarrjes;
- Përmbush detyrimet që burojnë nga traktatet ndërkombëtare, ligjet e Kosovës, licencat e operimit dhe KPMM-së;
- Administron në mënyrë të duhur proceset e prokurimit dhe transaksioneve financiare;
- Zhvillon politika dhe procedura efikase të burimeve njerëzore (duke përfshirë rekrutimin, menaxhimin e performancës, trajnimet, planifikimet e suksesshme, raportet e punonjësve dhe kompensimet) për të përkrahur objektivat strategjike të Ndërmarrjes;
- Shqyrton performancën vjetore, pagave të punëtorëve dhe të masave për motivim në punë;
- Përfaqëson ndërmarrjen brenda dhe jashtë Kosovë;
- Siguron vendosjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm, menaxhimit të informacionit duke i mundësuar ndërmarrjes të ekzekutoj aktivitetet e saj në mënyrë të ligjshme dhe etike;
- Vepron si ndërlidhje në mes të Menaxhmentit dhe Bordit Mbikëqyrës, komunikon në mënyrë efektive me palët e ndërlidhura, punëtorët e saj, Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe Ministrinë apo Agjencitë e saj, Institucione tjera të interesit, si dhe publikun;
- Organizon, mbikëqyr dhe mbanë përgjegjësi për të gjitha çështjet e biznesit të ndërmarrjes;
- Kryen dhe punë të tjera të përcaktuara me ligjet e zbatueshme, Statutin dhe aktet tjera të brendshme të ndërmarrjes.

Kryeshefi Ekzekutiv duhet të ketë:

- Aftësi të larta organizative, drejtuese (leadership), formulim politikash të ndërmarrjes, menaxhim strategjik dhe pune ekipore;
- Aftësi udhëheqjeje për arritjen e objektivave të përgjithshme të Trepça Sh.A., si dhe aftësi për të marrë vendime të rëndësishme në situata të vështira.
- Aftësi për implementimin e ndryshimeve të nevojshme dhe aplikimin e metodave të reja afariste për përballimin e sfidave të reja.
- Aftësi për zhvillimin dhe ruajtjen e marrëdhënieve me kolegë dhe punonjës të tjerë, që rezultojnë në një zgjidhje optimale për të mirën e ndërmarrjes.
- Zotësi për tu përshatë në situata të paplanifikuara apo të ndryshuara, fleksibilitet të planeve dhe masave për tu përballur me rrethanat e tilla.
- Zotësi të delegimit të autoritetit dhe përgjegjësisë tek bashkëpunëtorët për kryerjen e funksioneve të deleguara.
- Vendosmëri në zbatimin e masave disiplinore, për drejtues e punonjës në përputhje me ligjin dhe procedurat e korporatës.

KUALIFIKIMI DHE PËRSHTATSHMËRIA PROFESIONALE

Një kandidat për t'u zgjedhur në pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv duhet t'i përmbushë kriteret sipas Ligjit për Ndërmarrje Publike Nr. 03/1-087 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-111 dhe Ligjin 05/L-009, neni 21 Paragrafi 4 që i referohet dispozitave të mëposhtme:

- Të gjithë kandidatët potencial për këtë pozitë duhet të jenë persona me integritet të lartë të cilët i plotësojnë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1 (ii) i plotëson kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2 pikat (d), (f), (j), (k) dhe (l) , nuk janë, ose në çfarëdo kohe gjatë periudhës tridhjetë e gjashtë (36) muajsh para datës së aplikimit nuk kanë qenë Drejtorë të Bordit të kompanisë gjegjëse dhe (iv) kanë përvojën e nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar për pozitën në fjalë;
- Kandidati duhet të ketë diplomë universitare në fushën e: administrimit të biznesit, ekonomisë, shkencave teknike dhe inxhinierisë, juridik ose nga një fushë tjetër e shkencës e cila ka të bëjë me veprimtarinë biznesore. Preferohet edukim i avancuar (master) në sektorin relevant. Diplomat nga universitet jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara.
- Kandidati duhet të ketë së paku 5 vite përvojë pune në menaxhment të lartë, preferohen kandidatët me përvojë pune në ndërmarrjet/korporatat tjera të mëdha dhe me kompleksitet të lartë, duke përfshirë edhe kërkesat tjera që i parasheh neni 17 pika 3 e Ligjit 03/L-087, i ndryshuar dhe plotësuar më vonë;
- Kandidati duhet të ketë integritet të lartë personal dhe profesional për ushtrimin e pozitës të Kryeshefit Ekzekutiv në NPQ "Trepça" Sh.A.
- Të ketë njohuri të mirë të gjuhës angleze, në të folur dhe në të shkruar.
- Njohuri të mira të kompjuterit dhe pakos Microsoft Office;

INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT LIDHUR ME PROCEDURAT E KONKURIMIT

Kandidatët për pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv të “Trepça” Sh.A duhet të dorëzojnë këto dokumente:

1. Aplikacioni (shkarkohet nga web-faqja e Trepça Sh.A., <https://trepcasha.com/download/Trepca-Sha-Aplikacioni-per-punesim.doc>);
2. Deklarata nën betim (shkarkohet nga web-faqja e Trepça Sh.A., <https://trepcasha.com/download/Trepca-Sha-Deklarata-nen-betim.docx>);
3. CV - Biografia;
4. Letër motivuese ;
5. Kopje e ID/Pasaportës valide;
6. Kopjet e diplomave të noterizuara mbi kualifikimin arsimor dhe/ose nostrifikimin për diplomat e marra jashtë vendit;
7. Dëshmi te përvojës menaxheriale nga punëdhënësi (Dëshmi edhe nga trusti pensional);
8. Certifikatën (dëshminë) nga gjykata kompetente që dëshmon se nuk është nën hetime jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj.

Cdo përgenjshtrim i informatave, qoftë i qëllimshëm apo nga neglizhenca ose edhe ndryshim i tyre nga ato të deklarura më lartë do të rezultojë në skualifikim të menjëhershëm.

Dokumentacioni mund të dorëzohet përmes e-mailit: hr@trepcasha.com duke cituar në “Subjekt” titullin e pozitës që aplikon.

Kandidatet me dokumentacion të mangët, të pa plotësuar dhe jo adekuat do të refuzohen. Po ashtu, dokumentet e dorëzuara pas afatit të paraparë për mbyllje të konkursit publik nuk do të pranohet.

Afati i konkursit është i hapur 15 ditë nga data e publikimit në web faqen e Trepça Sh.A. dhe në shtypin ditor.

Afati i fundit për aplikim: 26.12.2023